

347.963:343.9.02

Prof.ass.PhD. Berat Aqifi¹

Armend Asllani, MA²

Marija Grozdanovska, Can. Phd³

**ROLI I PROKURORIT PUBLIK NË R.MAQEDONISË SIPAS
LIGJIT TË RI PËR PROCEDURË PENALE, NË LUFTIMIN E
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**УЛОГАТА НА ЈАВНИОТ ОБВИНИТЕЛ ВО Р.МАКЕДОНИЈА
СПОРЕД НОВИОТ ЗАКОН ЗА КРИВИЧНА ПОСТАПКА, ВО
БОРБА ПРОТИВ ОРГАНИЗИРАНИОТ КРИМИНАЛ**

**THE ROLE OF PUBLIC PROSECUTOR IN R.MACEDONIA IN
FIGHTING THE ORGANIZED CRIME IN LINE WITH THE NEW
LAW OF CRIMINAL PROCEDURE**

ABSTRACT

In the context of the French philosopher Montesquieu, “ The law of criminal procedure could be considered as a constitution for the ordinary people” it is inferred on the law of criminal procedure, which determines in the direct manner the individual rights and freedoms rather than do the constitutions of certain countries.

The reforms on the law of criminal procedure in republic of Macedonia resulted in a new rational and steady law. And as such being clear, it fulfills the standards of the rule of law, which represents a serious step forward, chiefly because the main objective of this procedure is to clarify that no innocent individual should be punished, on the other hand the guilty individual should receive the sanction in line with the criminal code as well as legal procedure.

¹ Ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti i Administrim Biznesit e-mail:berataqifi@hotmail.com

² Magjistër i shkencave juridike-drejtimi penal, e-mail:armend.asllani@unite.edu.mk

³ Ligjëruese në Sllavjanski Universitet, Phd kandidate në Shkencaat juridiko-penale.

The tendency of harmonization of the state legislation with the one of the member states of European Union was a fundamental need for a total structural reform of the criminal procedure, which will reach a consistent domestic criminal law with the EU, and at the same time it will be able to successfully respond to the challenges of a more full-bodied fight against organized crime, in general and in particular for the customs personnel. This brought the need for major changes not only in the structure of pre-trial and trial, but also in the organization and powers of major criminal proceedings.

In this paper, we aim to interpret and analyze through analysis and synthesis the provisions of the new Criminal Procedure Code, which came into force recently, regarding the role of the public prosecutor in criminal proceedings, particularly through the stages (stadiums) procedure, where according to this law, the public prosecutor gains a new leadership role, which will allow a better procedure, efficient and qualitative offense, especially in the preliminary procedure.

Key words: public prosecutor, the law of criminal procedure, the procedural stages

ABSTRAKT

Në kontekst të thënies së filozofit të njohur francez Monteskie, “**Ligji për procedurë penale duhet llogaritet si kushtetutë për njerëzit e rëndomtë**”, mendohet në Ligjin për procedurë penale që përcakton në mënyrë më të drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë individuale, se sa edhe vetë kushtetutat e vendeve të caktuara.

Reforma e Ligjit për procedurë penale në R. Maqedonisë rezultoi me një ligj të ri, koherent dhe logjikisht konzistent që për nga qartësia e tij i plotëson kriteret e postulateve të një shteti juridik, që paraqet një hap serioz, kryesisht në faktin se qëllimi kryesor i kësaj procedure është se askush i pafajshëm mos të gjykohet, kurse kryerësit të veprës penale t’i shqiptohet sanksioni penal në bazë të Kodit penal dhe procedurës së zhvilluar ligjore.

Tendenca e harmonizimit të legjislacionit vendas me legjislacionet e vendeve anëtare të BE-së, ishte nevojë imanente, për një reformë të përgjithshme strukturale të procedurës penale, me çka do të arrihet një përputhshmëri e ligjit penal vendas me atë evropian dhe njëkohësisht me sukses do të mundet ti përgjigjet sfidave për një luftë edhe më të fuqishme kundër krimit të organizuar, në përgjithësi dhe në veçanti atij doganor. Kjo solli nevojën e ndryshimeve të mëdha jo vetëm në strukturën e procedurës paraprake dhe atë gjyqësore, por edhe në organizimin dhe kompetencat e pjesëmarrësve kryesorë.

Në këtë punim nëpërmjet analizës dhe sintezës do të bëhen përpjekje të interpretohen dhe analizohen dispozitat e Ligjit të ri të Procedurës Penale që hyri në fuqi para pak kohe, lidhur me rolin e prokurorit publik në procedurën penale, veçanërisht nëpër fazat (stadiumet) procedurale, ku sipas këtij ligji,

prokurori publik fiton një rol të ri udhëheqës, ku do të mundësohet një procedurë më e mirë, efikase dhe kualitative penale, sidomos në procedurën paraprake.

Fjalët kyçe: prokurori publik, ligji për procedurë penale, fazat (stadiumet) procedurale.

1. HYRJE

Ligji i ri për procedurë penale është sjellë me 18.11.2010, ndërsa aplikimi i tij u prolongua për në 01.12.2013. Gjatë sjelljes së këtij ligji të ri, vendi ynë si model bazë morri modelet e procedurës penale të vendeve të ndryshme, por si më kryesor e akceptoi modelin Italian. Qëllimi reformues i këtij ligji është braktisja e hetueshmërisë gjyqësore dhe implementimi apo sjellja e një hetueshmërie më efikase dhe më produktive, hetueshmërisë prokurorike. Në këtë punim nëpërmjet metodës analitike do të shtjellojmë dispozitat, respektivisht risitë që i parashihet ligji i ri për procedurë penale, konkretisht në rolin e prokurorit publik si subjekt themelor në procedurën penale, gjegjësisht nëpër fazat procedurale.

2. Zhvillimi historik, nocioni dhe organizimi i prokurorit publik

Rrënjët e prokurorit publik datojnë që nga shek. XII, kur papa Inokentie i III ka vendosur ndjekje (ex officio) vetëm për disa vepra penale. Në formën e sotme prokuroria publike për herë të parë u paraqit në Francë në shek. XVIII, respektivisht ky prototip i prokurorisë bashkëkohore është rregulluar me Kodin mbi hetuesinë penale (Code d'instruction criminelle 1808) të Napoleon Bonapartës, ndërsa më vonë e njëjta u zgjerua në të gjitha shtetet e Evropës Kontinentale.⁴

Organizimi, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e prokurorisë publike janë të përcaktuara me Kushtetutën e RM-së, ligjin për prokurori publike dhe ligjin për procedurë penale.

Prokurori publik është subjekt dhe palë në procedurën penale, i cili në emër të shoqërisë dhe shtetit jep iniciativa për ngritjen e ndjekjes penale. Prokuroria publike organizohet sipas parimit të hierarkisë dhe suboordinimit. Prokuroria publike është e organizuar si Prokurori publike e RM-së, prokuroria publike më e lartë, prokuroria publike themelore për ndjekje të kriminalitetit të organizuar dhe korrupsionit si dhe prokuroria publike themelore.

⁴ Sahiti. E, & Zejneli. I, *E drejta e procedurës penale e R. së Maqedonisë*, f. 96.

3. Roli i prokurorit publik në procedurën penale sipas ligjit të ri për procedurë penale⁵

Vendi ynë para se të bëjë reformën e procedurës penale dhe me të, sjelljen e ligjit të ri, bëri një studim komparativ dhe si shembuj mori vendet si: Italinë, Anglinë, Bosnjën, Gjermaninë, Francën dhe Kroacinë, a veçanërisht si model kryesor u mor modeli italian ku prokuroria fitoi një pavarësi institucionale, dhe një autonomi funksionale në një procedurë bashkëkohore akuzatore. Ligji i ri për procedurë penale është sjellë me 18.11.2010, ndërsa aplikimi i tij është prolonguar për në 01.12.2013. Arsyeja e prolongimit ka qenë mosrealizimi i ndarjes së mjeteve të rëndësishme financiare, mospunësimi i kuadrit të nevojshëm, mosekzistimi i kapaciteteve hapësinore dhe mjeteve të teknologjisë informatike.

Qëllimi i reformës ishte arritja e një procedure më efikase penale nëpërmjet braktisjes së hetueshmërisë gjyqësore si e gjatë dhe e shtrenjtë dhe sjelljen e hetueshmërisë prokurorike sipas shembullit anglosakson. Këtu duhet theksuar se hetueshmëria gjyqësore tejkalohe, d.m.th. nuk zëvendësohet me ndonjë hetueshmëri formale akuzuese⁶. Me ligjin e ri të procedurës penale ndryshon roli i prokurorit publik. E drejta dhe obligimi themelor i PP është që t'i ndjekë kryerësit e veprave penale për të cilët ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare⁷. Në lëndët e veprave penale për të cilat ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare, prokurori publik ka të drejtë dhe obligim:

-T'i drejtojë veprimet e organeve kompetente për zbulimin dhe paraqitjen e veprave penale dhe kryerësve të tyre;⁸

-Të propozojë ose japë urdhër për ndërmarrjen e masave të veçanta hetimore, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj;⁹

-Të japë urdhra dhe të zbatojë procedurë hetimore;¹⁰

-Të gjejë, propozojë dhe sigurojë prova, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj;¹¹

⁵ Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.150/2010.

⁶ Калајхијев, Гордан, “Замки и заблуди на реформата на истрагата”, Зборник на трудови-Скопје&Загреб, 2009.

⁷ Ligji për procedurë penale, Gaz.Zyrtare e R.M-së, nr.150/2010 (neni 39, paragrafi 1).

⁸ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 1.

⁹ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 2.

¹⁰ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 3.

¹¹ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 4.

-Të propozojë masa të përkohshme për sigurimin e pronës ose sendeve të marra me veprën penale ose për zbatimin e masës së konfiskimit;¹²

-Të vendosë për prolongimin e ndjekjes penale nën kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me këtë ligj;¹³

-Të propozojë lëshimin e urdhër ndëshkimit nën kushtet të përcaktuara me këtë ligj;¹⁴

-Të negociojë dhe të merret vesh me të akuzuarin për pranimin e fajit, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj;¹⁵

-Të parashtrojë dhe përfaqësojë aktakuza para gjykatës kompetente;¹⁶

-Të parashtrojë ankesa kundër vendimeve gjyqësore jo të plotfuqishme dhe mjete juridike të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore të plotfuqishme;¹⁷

-Të vendosë për ankesën e të dëmtuarit; si dhe veprime të tjera.¹⁸

Si reformë më e madhe në rolin e prokurorit publik sipas ligjit të ri për procedurë penale është dhënia e urdhrit për zbatimin e procedurës hetimore.

3.1. Procedura parahetimore

Sipas dispozitave të reja, si dhe në përshtatshmëri me trendet ndërkombëtare, dominus litis i fazës paraprake është prokurori publik. Për shkak realizimit të funksionit të ndjekjes penale, prokurori publik udhëheq me procedurën parahetimore dhe e ka në disponim policinë gjyqësore¹⁹. Policia gjyqësore është një lloj policie kriminalistike e cila bashkëpunon ngushtë me prokurorinë publike, dhe një pjesë e saj e vogël do të jetë në qendrat hetimore të prokurorisë publike.

Ideja me reformimin e rolit të prokurorisë publike me ligjin e ri është që ai të inkuadrohet në rastet më serioze, jo me qëllim që ta zëvendësojë policinë, por ta udhëheqë me qëllim grumbullimin më efikas dhe më kualitativ të informatave dhe dëshmive të cilët do të ndihmojnë që

¹² Ibid, neni 39, paragr.2, pika 5.

¹³ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 6.

¹⁴ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 7.

¹⁵ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 8.

¹⁶ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 9.

¹⁷ Ibid, neni 39, paragr.2, pika 10.

¹⁸ Ibid, neni 39, paragrafi 2, pika 11.

¹⁹ Ibid, neni 41, paragrafi 1.

ai të fitojë rastin nëse i njëjti arrin në gjyq. Risi në sferën e prokurorit publik është formimi i qendrave hetimore sipas ligjit të ri për procedurë penale. Për nevojat e procedurës penale, për rajonin e një ose më tepër prokurorive publike formohen qendra hetimore të prokurorisë publike.²⁰ Punëtorët të cilët janë të zgjedhur që të punojnë në qendrën hetimore i janë në dispozicion prokurorit publik, punojnë nën kontroll dhe nën urdhra të tij dhe për punën i përgjigjen prokurorit publik.²¹

Prokurori publik dhe policia e jurisprudencës për veprën e kryer penale njoftohen nga vërejtja e drejtpërdrejtë, nga zëri i arritur ose pas marrjes së padisë penale²².

Kallëzimi penal parashtrohet te prokurori publik me shkrim ose me gojë, me telefon, në formë elektronike ose me përdorimin e mjeteve dhe mënyrave tjera teknike²³. Si risi tjetër e këtij ligji të ri është parashtrimi i kallëzimit penal përmes aparaturës elektronike, e cila mundësi nuk ekzistonte në ligjin e vjetër.

Ligji i ri për procedurë penale për herë të parë e rregullon procedurën e identifikimit në polici. Sipas ligjit të ri për procedurë penale policia e jurisprudencës mund të zbatojë këto metoda për identifikim: me vëzhgim, me identifikim; me videofilm dhe me përballje²⁴. Policia e jurisprudencës mund të thërrasë qytetarë për mbledhjen e njoftimeve për veprat penale dhe kryerësin.²⁵ Në bazë të njohurive të mbledhura policia gjyqësore përpilon kallëzim penal për veprimet e kryera në të cilin i thekson edhe argumentet që i ka zbuluar²⁶. Roli shprehës i prokurorit publik është pas marrjes së kallëzimit penal ose njoftimit nga policia.

Varësisht nga dëshmitë me të cilën disponon prokurori publik, pas pranimit të kallëzimit penal, mundet të veprojë në njërin nga këto mënyra:

-Prokurori publik mundet ta dorëzojë kallëzimin penal deri te prokurori publik kompetent (neni 274, paragrafi 4 i LPP);

-Vetë prokurori publik ose me anë të policisë gjyqësore (jurisprudencës) ose personave të punësuar në qendrat hetimore mbledh njoftime, të nevojshme për vendosjen në kallëzimin penal (neni 285 i LPP);

²⁰ Ibid, neni 45, paragrafi 1.

²¹ Ibid, neni 45, paragrafi 6

²² Ibid, neni 272.

²³ Ibid, neni 274, paragrafi 1.

²⁴ Ibid, neni 278.

²⁵ Ibid, neni 279.

²⁶ Ibid, neni 280.

-Prokurori publik mundet të thërras dorëzuesin e kallëzimit penal ose persona të tjerë për besueshmërinë e konstatimeve (neni 285, paragrafi 1 i LPP);

-Prokurori publik mund të thërras edhe të dyshuarin (neni 285, paragrafi 2 i LPP);

-Nëse është e nevojshme prokurori publik ose policia mundën me pëlqim nga gjyqi të grumbullojnë informacione nga personat që gjenden në paraburgim (neni 286 i LPP);

-Prokurori publik mund të kërkojë nga organet shtetërore, organet e vetëqeverisjes lokale, personave fizik dhe juridik që kryejnë funksione publike t'i dorëzojnë informacione. (neni 287 i LPP);

-Prokurori publik mund të sjellë vendim për hedhje poshtë të kallëzimit penal (neni 288 i LPP);

-Prokurori publik mund të sjell vendim për prolongimin e ndjekjes penale (neni 43 i LPP);

-Prokurori publik mund të sjellë vendim për mosndërmarrjen e ndjekjes penale sipas nenit 44 të LPP;

-PP mund të sjellë urdhër për zbatimin e procedurës hetimore (neni 292 i LPP).

Sipas ligjit të ri për procedurë penale prokurori publik është i obliguar që të veprojë në afat prej tre muajsh pas pranimit të kallëzimit penal. Nëse gjatë këtij afati prokurori publik nuk vendos për kallëzimin, është i obliguar ta njoftojë me shkrim parashtruesin e kallëzimit penal dhe prokurorin publik më të lartë.

3.2. Procedura hetuese

Ligji për procedurë penale i RM-së, mbështetet tek modeli italian, i cili është ligji i vetëm për procedurë penale në Evropë ku siguron mekanizma të vërtet efektiv për sigurimin e rolit udhëheqës të prokurorisë publike në hetime. Risia kryesore e ligjit është heqja e hetueshmërisë formale, e hetueshmërisë gjyqësore. Hetueshmëria gjyqësore e prolongonte pa nevojë hetimin, i jepte karakter inkuizitor, duke e pasur parasysh se ajo ishte një lloj “gjykimi para gjykimit”. Në hetueshmërinë gjyqësore sillëshin pothuajse dëshmitë më të rëndësishme, ku më vonë përdorëshin në seancën kryesore si bazë e aktgjykimit. Me këtë roli i prokurorit publik pasivizohej, dhe prej gjykatësit hetues dhe policisë

pritej që t'i grumbullojnë dhe t'ia dorëzojnë materialet e grumbulluara prokurorit publik²⁷.

Si reformë në rolin e prokurorit publik sipas ligjit të ri për procedurë penale është autorizimi i prokurorit publik për të sjellë urdhër për realizimin e procedurës hetimore.

Pas sjelljes së urdhrimit për realizimin e procedurës hetimore, prokurori publik mundet:

- Të dorëzojë propozim deri te gjykatësi i procedurës paraprake për: caktimin e masës së paraburgimit; kontrolli i shtëpisë, hapësirave dhe personave tjerë; zbatimi i masave të veçanta hetuese; sigurimi i parakohshëm i pronës-neni 294, paragrafi 1,2,3,4 i LPP;

- Të kërkojë nga gjykatësi i procedurës paraprake të zbatojë seancë dëshmuese-neni 294, paragrafi 5 i LPP;

- T'i ndërmarrë këto veprime hetuese: kontrollim; sigurim të parakohshëm dhe marrjen e lëndëve dhe pronës; marrjen në pyetje të dyshuarin; marrjen në pyetje dëshmitarët, ekspertizë; rikonstruim dhe masa të veçanta hetuese-neni 295 i LPP;

- Me urdhër të ndërpresë procedurën hetuese-neni 300 i LPP;

- Prokurori publik ngritë akuzë-neni 301 i LPP;

- Të ndërpresë procedurën hetuese-neni 301, 304 i LPP

Si risi në ligjin e ri për procedurë penale është mundësia për drejtimin e hetimit të veçantë edhe të mbrojtjes. Avokatit i mundësohet të kërkojë dëshmitarë dhe dëshmi materiale në mënyrë aktive.

3.3. Akuzimi

Pas përfundimit të procedurës hetuese, nëse prokurori publik vlerëson dhe konstaton se ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme nga të cilat mund të pritët miratim i aktgjykimit dënues, e përgatitë dhe parashtron aktakuzën në gjykatën kompetente²⁸. Vlerësimin e aktakuzës e bën gjykatësi individual për ato vepra penale ku parashihet dënimi deri në 10 vjet, ndërsa këshilli gjykues bën vlerësimin e aktakuzës për veprat penale prej 10 vjet e më rëndë. Gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës mund të vendosë në disa mënyra të ndryshme: të sjellë vendim, me të cilën kundërshtimin do ta refuzojë se është jo me kohë

²⁷ Матовски, Никола, “Моделот на истрагата”, во Зборник на трудови на Правниот факултет “Јустиниан први”, Скопје, 2007.

²⁸ Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.150/2010, neni 319

ose i deklaruar nga personi jo i autorizuar²⁹; të sjellë vendim, me të cilën do ta refuzojë aktakuzën si të pabazë në lidhje me të gjitha ose disa vepra penale³⁰; si dhe të sjellë vendim për pëlqimin e aktakuzës, e cila duhet të jetë e arsyetuar.

3.4. Seanca kryesore

Sa i përket ligjit të vjetër (të shfuqizuar), seanca kryesore ishte më tepër me elemente inkuizitore. Gjyqi luante një rol dominues në vërtetimin e të drejtës materiale, në marrjen e dëshmitarëve dhe të pandehurit në pyetje, në parashtrimin e dëshmive ex officio etj. Ndërsa sipas ligjit të ri për procedurë penale, seanca kryesore është me karakteristika akuzuese. Këtu kemi një aktivitet të madh të palëve të mbështetur në parimin e kontradiktës. Si mjete më dinamiko-inovative, që do t'iu shërbejë tej mase prokurorit dhe avokatit të mbrojtjes janë pyetjet direkte, të kryqëzuara dhe plotësuese, që i parasheh ligji i ri për procedurë penale. Sa i përket rolit reformues të prokurorisë publike, nga ai në procedurën penale kërkohet mençuri, gjeturi, mendjemprehtësi, aftësi, precizitet në përgatitjet dhe prezantimet e dëshmive para gjyqit.

3.5. Marrëveshja për pranimin e fajit

Ligji i ri për procedurë penale përmban dispozita, ku për herë të parë rregullohet mundësia për marrëveshje ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal. Me sjelljen e mundësisë për marrëveshje për pranimin e fajit me ligjin e ri të procedurës penale, pritët shkarkimi i gjyqësisë për pjesën e lëndëve, me të cilën palët do të arrijnë marrëveshje; gjykatësit të kenë kohë më shumë për përkushtimin në lëndët më komplekse penale me situatë të ndërlikuar faktike; zvogëlimin e shpenzimeve të procedurave gjyqësore me faktin se dukshëm shkurtohet kohëzgjatja prej fillimit të procedurës penale deri te sjellja e aktgjykimit; një rol më aktiv i palëve; përfundimi i procedurës në fazën më të hershme me sjelljen e vendimit meritor; mandej pritët një

²⁹ I akuzuari ose mbrojtësi i tij mundën në afat prej 8 ditësh nga pranimi i aktakuzës të parashtrajnë kundërshtim kundër aktakuzës. Mandej vjen në shprehje vlerësimi i aktakuzës nga gjykatësi ose këshilli.

³⁰ Këtë e bënë nëse konstaton se vepra që është lëndë e aktakuzës nuk është vepër penale, ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe nuk ka bazë për zbatimin e masave të sigurisë, nuk ka kërkesë nga paditësi i autorizuar, propozim të të dëmtuarit ose pëlqim nga organi kompetent shtetëror si dhe nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme në dobi të akuzës.

zotësi e mbrojtjes (avokatit) që të vlerësojë se sa është e favorshme përgatitja e klientit të tij për pranimin e fajit para gjyqit kundrejt pritjes së verdiktit final që kalon nëpër fazat e ndryshme procedurale.

Me rolin e këtillë të prokurorit publik pritet një veprim i tij aktiv në kuptimin e inicimit të procedurës për marrëveshje dhe përpjekje për arritjen e një sanksioni të pranueshëm penal të ndërsjellë për veprën ose veprat për të cilat ai ka dhënë urdhër për zbatimin e procedurës hetuese.

Konkluzion

➤ Reforma esenciale e ligjit të ri për procedurë penale është heqja (braktisja) e hetuesisë gjyqësore dhe sjellja e hetuesisë prokurorike. Me ligjin e ri hetuesia e prokurorit dhe asaj policore ndërmjet vete plotësohen, ndërsa hetuesia gjyqësore praktikisht tejkalohet.

➤ Prokurori publik në procedurën e re penale nuk do të zëvendësojë gjykatësin hetues në kuptimin e marrjes së veprimeve formale hetuese, që është ideja e parë ku njerëzve u bie në mend. Prokurori publik fiton një rol të ri, me të cilën duhet të mundësohet një procedurë më e mirë, më efikase dhe më kualitative penale.

➤ Prokurori publik do të kryejë rolin e koordinatorit profesional, moral, etik, aktiv, konstruktiv dhe konkret të aktiviteteve për zbardhjen e veprës penale, gjetjen e kryerësit të veprës penale dhe sigurimin e informacioneve të mjaftueshme dhe dëshmimeve për përfundimin e suksesshëm të procedurës penale. E gjithë kjo është e mundur vetëm me veprimin depolitizues dhe joselektiv ndaj kallëzimeve penale nga ana e prokurorit publik.

➤ Roli i këtillë redefinues i prokurorit publik, mundësohet nga ligji i ri për procedurë penale, si një ligj logjik, koherent dhe konzistent, i cili duhet të mundësojë një veprim të suksesshëm të gjyqësisë penale në trekëndëshin magjik, respektivisht të jetë efektiv, efikas dhe t'i plotësojë kërkesat për procedurë të drejtë me qëllim që t'i mbrojë të drejtat e individit.

Conclusion

➤ The new essential law reform for criminal proceedings is the removal of the investigating court and the bring of the investigating prosecution. By the new law the investigating prosecution and the police one will be completed, while the investigating court virtually will overcome.

➤ Public prosecutor in the new penal procedure it wont replace the investigator judge in the meaning of talking the operation of official interrogations, wich is the 1-st idea that comes in peoples mind. Public prosecutor gets a new role with wich a good opportunity will overcome, more efficient and with more penal quality.

➤ Public prosecutor shall perform the role of professional coordinator moral, ethical, active, constructive and concrete of activities to solve the crime, finding the committer of criminal act and providing sufficient information and evidence of successful completion of the criminal proceedings. All this is possible only with the de-polizitation action and non-selective against criminal charges by the public prosecutor.

➤ This redefined role of public prosecutor is enabled by the new law for criminal procedure, as a logic law, concrete and consistent, wich must enable a successful action of criminalistic justice, in the magic triangle, respectively to be effective, efficient and fulfill the requirements for a right procedure in order to protect the individual rights.

Bibliografia:

1. Sahiti, Ejup, & Zejneli, Ismail, *E drejta e procedurës penale e R. së Maqedonisë*, Tetovë, 2007.

2. Калајчиев, Гордан, “Замки и заблуди на реформата на истрагата”, Зборник на трудови-Скопје&Загреб, 2009.

3. Матовски, Никола, “Моделот на истрагата”, во Зборник на трудови на Правниот факултет “Јустиниан први”, Скопје, 2007.

4. А. Трајковска, „Улогата на јавниот обвинител и правосудната полиција во согласност со предлозите во новиот ЗКП“, во МРКПК бр. 2, 2009г.

5. Schick, Die Staatsanwaltschaft – eine Justiz – verwaltungs – Behörde (цитирајќи го Lebensschatten E. Frieda 1981) во Urlich/Schnedl/Pirstner – Ebner (Funktionen des Rechts in der pluralistischen Wissensgesellschaft, Bohlau, Wien, 2007

6. Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.150/2010

7. Ligji për prokuror publik, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.150/2007

8. Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.144/206